

REKOMANDIMET NGA KONFERENCA E PESTË NDËRKOMBËTARE “AUDITIMI I SIGURISË RRUGORE DHE ZVOGËLIMI I AKSIDENTEVE NË TRAFIK”, 24 JANAR 2018, PRISHTINË

- Auditimi i sigurisë rrugore është proces i domosdoshëm i cili duhet të zbatohet në fazat e projektimit dhe ndërtimit dhe të vazhdohet me inspektime periodike, që të evitohen mangësitë e identifikuar me qëllim të rritjes së sigurisë rrugore, në mënyrë që numri i aksidenteve në rrugë të mbahet në minimum.
- Siguria rrugore është përgjegjësi e përbashkët e cila nuk i përket vetëm Qeverisë, Policisë ose ndonjë institucioni tjetër, por të gjithë përdoruesve të rrugës.
- Trajnimi i bazuar në sjelljen e shoferit është zgjidhje adekuate për rritjen e sigurisë rrugore, pasi e mëson shoferin ta pranojë rrjedhën e trafikut ashtu siç është, t'i përshtatet situatës dhe të qëndrojë i qetë dhe i fokusuar.
- Përcaktimi i shpejtësisë së lëvizjes me ndihmën e sistemeve inteligjente mund të garantojë një reduktim të konsiderueshëm të numrit të aksidenteve me pasoja fatale dhe me lëndime.
- Inspektimi i vendeve të rrezikshme të ndodhjes së aksidenteve në mënyrë që përmes hulumtimit të bazuar të gjenden zgjidhje për të përmirësuar infrastrukturën rrugore dhe elementet tjera përcjellëse të sigurisë, me qëllim të parandalimit të aksidenteve dhe ngritjen e sigurisë rrugore.
- Aplikimi i pajisjeve inteligjente dhe aplikacioneve të ndryshme softuerike gjatë programeve të trajnimit të shoferëve për patentë shoferë.
- Arritja e objektivave të BE-së për sigurinë rrugore dhe realizimi i vizionit "Zero aksidente" nuk mund të imagjinohet pa mbështetjen thelbësore të shkencës/arsimit dhe ndikimit të madh të vullnetit politik (institucioneve qendrore apo lokale).
- Në bazë të hulumtimeve të zhvilluara deri më tani me nxënës të shkollave të ndryshme nga Komuna të Republikës së Kosovës, përzehjen e të cilave e bënë gjithmonë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, rezulton se përfshirja e lëndës “Edukata në trafik” në kurrikulat shkollore është veprim i domosdoshëm dhe i menjëhershëm që duhet të ndërmerret nga institucionet përkatëse.
- Hartimi i aplikacionit “Harta dixhitale” që paraqet lokacionet ku kanë ndodhur aksidentet rrugore, që përfshijnë numrin e aksidenteve fatale, me lëndime dhe dëme materiale, qasje kjo që të ju mundësohet të gjithë të interesuarve.
- Aplikimi i njoftimeve përmes web faqeve zyrtare dhe rrjeteve sociale lidhur me të gjitha aktivitetet që zhvillohen në rrugë, si: punimet në rrugë, bllokimet në rrugë për shkak të aksidenteve rrugore, aktiviteteve sportive, ngarkesa në trafik brenda dhe hyrje/dalje në RKS-së, etj.